



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-029

Prishtinë, më 24 nëntor 2020, në orën 14:00
Në distancë, përmes platformës online ZOOM 5.0.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 NËNTOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit, Arbërie Nagavci, Kujtim Shala dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Arben Gashi, Ariana Musliu-Shoshi, Teuta Haxhiu dhe Endrit Shala.

Në mbledhje ishin pjesëmarrës:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancë të re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9 nëntor 2020.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

3. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi pikat 2 dhe 3 të lartshënuara të rendit të ditës dhe pas diskutimeve, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të premten, më 27 nëntor 2020, dhe të hënën, më 30 nëntor 2020, t'i mbajë dy (2) seanca plenare, si dhe të enjten, më 3 dhjetor 2020, ta mbajë një (1) seancë të veçantë, si në vijim:

1. Vazhdimi i seancave plenare do të mbahet të premten, më 27 nëntor 2020, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 21 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-025 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit - nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit,
2. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-035 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për likuiditet të urgjencës së infrastrukturës vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
3. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-036 për ratifikimin e Kontratës Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan,
4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë,
5. Votimi në parim i Projekt-Kodit Civil të Republikës së Kosovës nr. 07/L-019.

- Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25, 28 shtator, 8, 16 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e nënshkruar edhe nga 9 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës,
4. Votimi në parim i Projektligjit për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë COVID-19.

- Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8, 12, 16 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-018 për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Besa Ismaili-Ahmeti, mbështetur edhe nga 8 deputetë të GP të PDK-së, në lidhje me përgjegjësitë në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel lidhur me punën e grupeve teknike.

- Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 21 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me pezullimin njëvjeçar i aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përfshirjen e Republikës së Kosovës në “Zonën e mini-Shengenit ballkanik”,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me deklarin dhe qëndrimin e Kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

- Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 29 tetor, 2 dhe 3 nëntor 2020:

6. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-021 për të drejtat pronësore të shtetaseve të huaj në Republikën e Kosovës,
8. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për tu kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës,
10. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të Auditimit për vitin 2019,
11. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që të mbajë të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidale në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur,
12. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me sensibilizimin dhe masat që duhet të ndërmerren nga Qeveria dhe institucionet përgjegjëse në luftën kundër kancerit të gjirit.

- Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 13 nëntor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së 8 deputetëve të GP të LVV-së, në lidhje me shfuqizimin e Task-forcës antikorruption në Policinë e Kosovës.

- Pikat e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 19 dhe 23 nëntor 2020:

4. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen “Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur”,
5. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-033 për të drejtën ndërkombëtare private,
6. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-027 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social,
7. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës,
8. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-038 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike,
9. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-012 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256,
10. Shqyrtimi i raportit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
11. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2019,
12. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019,
13. Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2019,
14. Votimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2019,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019,
16. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga radhët e komunitetit shqiptar,
17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës për vazhdimin e mandatit dhe miratimin e buxhetit,
18. Interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, mbështetur edhe nga 5 deputetë të tjerë, në lidhje me shmangien për të raportuar në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

* * *

Ndërsa, seanca e jashtëzakonshme, e kërkuar nga 51 deputetë, e shtyrë nga data 6 dhe 11 nëntor 2020, me kërkesë të kryetarit të GP të LDK-së, Arben Gashi, në emër të 51 deputetëve, u shty përsëri për ndonjë ditë tjetër.

* * *

II. Seanca e re plenare do të mbahet të hënën, më 30 nëntor 2020, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-005 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, me Ligjin nr.04/L-116, me Ligjin nr.04/L-194, me Ligjin 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L-007,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-043 për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë,*
5. *Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024,*
6. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2019,*
7. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2019,*
8. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2019,*
9. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2019,*
10. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2019,*
11. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2019,*
12. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019,*
13. *Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit të NP KOSTT,*
14. *Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit.*

* * *

Kryesia, në lidhje me përgatitjet për seancën e re plenare, vendosi si në vijim:

- Interpelanca me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, e nënshkruar edhe nga nëntë (9) deputetë tjerë, në lidhje me dhënien e licencave afatgjate (40 vjet) për prodhimin e energjisë elektrike ndërmarrjes “KELKOS ENERGY” sh.p.k. për HC “Deçani” dhe HC “Belaja”, e cila nuk kishte marrë përgjigje nga Qeveria në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, e që duhej të radhitej pikë e parë e rendit të ditës të ditës të seancës së re plenare, shtyhet derisa të shërohet ministri Blerim Kuçi.

- Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e paraparë për seancën e re plenare, shtyhet për të pritur një opinion ligjor nga Administrata e Kuvendit dhe në lidhje me këtë pikë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që ta përgatisë një opinion ligjor në lidhje me plotësimin e kriterëve ligjore të njërit nga kandidatët e propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

- Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit të NP KOSTT dhe

- Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, me propozim të Kryetarit të Komisionit funksional për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, Endrit Shala, të radhiten në rendin e ditës të seancës së re plenare, në pikat 13 dhe 14 të lartshënuara.

* * *

Më pas, Kryesia me propozim të kryetarit të GP të LDK-së, Arben Gashi, në lidhje me kërkesën e deputetit Fetah Rudi, i mbështetur nga 7 deputetë tjerë, për debat parlamentar për gjendjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, vendosi që:

III. Seanca e Veçantë do të mbahet të enjten, më 3 dhjetor 2020, në orë 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentare për gjendjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

* * *

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave:

1. Njoftimi në lidhje me konkursin për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me njoftimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Të rishpallet konkursi publik për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ta publikojë ri-shpalljen e konkursit nga pika një (1) e këtij vendimi.

2. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Republikës Popullore të Bangladeshit

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi i Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Republikës Popullore të Bangladeshit.
2. Kërkohe nga grupet parlamentare që para mbledhjes së radhës së Kryesisë së Kuvendit t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Grupit të Miqësisë nga pika një (1) e këtij vendimi.
3. Kryetari i këtij grupi duhet të jetë nga GP i PDK-së, ndërsa nënkryetari nga GP Nisma/AKR.

5. Të ndryshme

1. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Kujtim Shala, për ngritjen e pagave të vozitësve të nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohe nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një propozim për pagat e vozitësve të nënkryetarëve të Kuvendit dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë për miratim.

2. Kërkesa e kryetarit të GP të LDK-së, Arben Gashi, për përfshirje në listën e pagave të zëvendësueses së asistentes së këtij grupi parlamentar

Kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, i njoftoi të pranishmit se asistentja e këtij grupi parlamentar është në pushim të lindjes dhe kërkoi që zëvendësuesja e saj të përfshihet në listën e pagave.

Diskutimi i plotë i të cilit është i dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar, kryetarja tha se duhet të dërgohet kërkesa.

3. Staf i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë

Kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, e shtroi çështjen e stafit për Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Acociim BE - Kosovë, kryesues i të cilit delegacion është vetë ai.

Diskutimi i plotë i të cilit është i dhënë në transkript.

4. Çështja e automjeteve për kryetarët e grupeve parlamentare

Kryetari i GP të LDK-së, Arben Gashi, e shtroi çështjen e sigurimit të automjeteve për kryetarët e grupeve parlamentare, diskutimi i të cilit është i dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani, Endrit Shala, në emër të GP Nisma/AKR, dhe Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Po ashtu, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, dha sqarime në lidhje me procedurat e prokurimit për automjetet të zhvilluara nga Autoriteti Qendror i Prokurimit. Diskutimi i plotë i Sekretarit është dhënë në transkript.

5. Çështja e zyrave për deputetët

Deputetja Ariana Musliu-Shoshi, në emër të GP të PDK-së, e shtroi çështjen e zyrave për deputetët, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, si dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Po ashtu, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, dha sqarime në lidhje me përfundimin e punimeve për renovimin e aneksit të objektit të Kuvendit dhe hapësirave të aneksit.

Diskutimi i plotë i Sekretarit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetarja konstatoi që Administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me këshilltarët e kryetares dhe me nënkryetarët e Kuvendit, ta përgatisë skemën e zyrave dhe pastaj Kryesisë së Kuvendit t'i propozohet për miratim.

6. Çështja e përfaqësimit në komisionet parlamentare pas shuarjes së GP 6+

Kryetarja e shtroi çështjen e përfaqësimit të grupeve parlamentare nëpër komisionet parlamentare, pas shuarjes së GP 6+.

Diskutimi i kryetares është i dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Po ashtu, edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, tha se së shpejti do të përgatisë sqarime sipas formulës së kryesimit dhe përfaqësimit në komisionet parlamentare. Diskutimi i plotë i Sekretarit është dhënë në transkript.

7. Çështja në lidhje me mandatin e deputetit Etem Arifi

Nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, e shtroi çështjen e mandatin të deputetit Etem Arifi.

Diskutimi i nënkryetares është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani, dhe Endrit Shala, në emër të GP Nisma/AKR, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

8. Çështja në lidhje me zhvillimin e seancave të fundit

* Kryetarja e shtroi çështjen e debatit parlamentar në lidhje me gjendjen pandemike në vend dhe menaxhimin e situatës me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës nga Qeveria, të zhvilluar në seancën plenare të Kuvendit, më 17 nëntor 2020, si dhe dha sqarime për procedurat e ndjekura për atë debat parlamentar.

Diskutimi i kryetares është dhënë në transkript.

* Po ashtu, u diskutua edhe për zhvillimin e seancës plenare të Kuvendit, të mbajtur më 19 nëntor 2020, nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen “Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur”.

Në lidhje me çështjet e lartshënuara, diskutuan: Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, si dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:35 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale